

PRODHIM MOBILJE Sha

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare të mbyllura më 31.12.2021.

1- Të dhëna të përgjithëshme

Shoqëria "Prodhim Mobilje" sha është krijuar me Vendimin Nr. 20304, nga Gjykata e Rrethit Tiranë datë 10.11.1998, si një shoqëri anonime me kapital 100% shtetëror.

Krijimi i kësaj shoqërie është bazuar në nenin Nr. 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin Nr. 1 të Ligjit 8885 datë 24.04.2002 "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 7926 datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregëtare". Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si dhe statuti i saj.

Shoqëria "Prodhim Mobilje" sha është një shoqëri vendase me adresë Rruga e Kavajës, Tiranë me ortak të vetëm Ministrinë e Ekonomisë dhe Financës, e cila zotëron 100% të pjesëve të kapitalit të shoqërisë. Objekti i aktivitetit të shoqërisë sipas statutit të saj është – Prodhim Mobilje e orendi prej lëndë druri si: Pajisje zyre, shkollash, dhoma gjumi, stazhonim, prodhime me porosi dhe material porositës.

Aktualisht shoqëria nuk e ushtron këtë aktivitet, por administron asetet e pasurisë së paluajtshme dhe i jep ato me qira të tretëve duke realizuar të ardhura.

Kjo shoqëri është e regjistruar pranë organeve tatimore të Rrethit Tiranë me NIPT J61827055V.

a) Kapitali dhe pronësia

Kapitali i Shoqërisë "Prodhim Mobilje" sha është 22,474,440,565 lekë me vlerë nominale të një aksioni 1000 lekë/aksioni 22,474,440.565 lekë. Kjo vlerë është totalisht e shlyer nga aksioneri i vetëm shtetëror Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

b) Administrimi

Struktura organike, Administrimi, Organizimi, Drejtimi i përshtaten natyrës së Shoqërisë dhe realizimit të objektit të veprimtarisë së saj. Organet drejtuese të shoqërisë janë Këshilli Mbikqyrës dhe Administratori i Shoqërisë. Këshilli Mbikqyrës me mbylljen e vitit 2021 përbëhet nga:

- 1 – Znj. Gjinovefa Harizaj (Kryetar)
- 2 – Z. Fjorind Lika (Anëtar)
- 3 – Z. Florion Serjani (Anëtar)

Administrator i shoqërisë në 31.12.2021 është Z. Arben Seferaj

Numri total i punonjësve në 31.12.2021 është 26 (njëzet e gjashtë punonjës)



Përmbledhja e politikave kontabël

Bazat e mbajtjes dhe përgatitjes së pasqyrave financiare

- Organizimi i Kontabilitetit

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me legjislacionin Shqiptar " Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit . Ato janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit të drejtave të konstatuara .Ato paraqiten në monedhën vendase , Lek Shqiptar(lekë)

Standartet Kombëtare të Kontabilitetit aplikohen ,sipas kërkesave SNK- ve në mënyrë perspective. Si pasojë, shifrat e vitit 2021 janë të krahasueshme me ato të viteve paraardhëse ,pasi janë zbatuar politika kontabile të njëjta.

Kontabiliteti mbahet në mënyrë të informatizuar nëpërmjet programit të kontabilitetit , Program Exel.

- Akivet Afatgjata Materiale paraqiten në bilanc me vlerën e tyre neto .

Akivet Afatgjata Materiale të ndara në zërat si toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje ,pajisje zyre e informatke të klasifikuara sipas SKK 5, të cilat janë përfshirë në pasqyrat financiare duke ndjekur politikën kontabël , *Kosto e blerjes ose prodhimit ose shuma e rivlerësimit minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin në qoftë se ka.* Metoda e llogaritjes së Amortizimit bëhet në zbatim të ligjit nr. 8438 datë 28.12.2008 " Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar . Baza e llogaritjes së amortizimit bëhet mbi vlerën neto kontabël. Llogaritja e amortizimit për Akivet Afatgjata Materiale dhe Jomateriale të bëra hyrje gjatë vitit, është bërë duke filluar nga data 1 e muajit pasardhës.

Njohja dhe matja

Zërat e Aktiveve afatgjata material paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet ,si rezultat i rivlerësimit , kjo rritje kreditohet drejtëpërdrejtë në kapitalet e veta nën zërin " tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Për llogaritjen e amortizimit të aktiveve afatgjata material është përdorur metoda lineare për ndërtesat dhe mbi bazën e vlerës së mbetur për pjesën tjetër të aktiveve të qëndrueshme Normat e përdorura janë për ndërtesat 5% të vlerës së mbetur dhe për pjesën tjetër të aktiveve 20% deri në 25% .

- Gjendjet e Inventarit

Vlerësimi në hyrje i inventarëve bëhet me çmimin e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuar për të sjellë inventarët në kushte magazinimi. Gjendja e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjes të fundit të ushtrimit që nga drejtimi është çmuar si vlera neto e realizueshme.



- **Kurset e Këmbimit**

Asetet jo monetare vlerësohen me kursin e këmbimit në datën e trasaksionit, Asetet monetare në valutë vlerësohen me kursin zyrtar të publikuar nga Banka e Shqipërisë. Diferenca e kursit fitim (humbjet) kontabilizohen sipas përcaktimeve në kontabilitet

Kurset e këmbimit të përdorura nga shoqëria përmonedhat e huaja kryesore më 31.12.2021 sipas BSH

Monedha	Viti 2020	Viti 2021	Ndryshimi
EURO	123.7	120.76	-2.94
USD	100.84	106.54	5.7

- **Tatimi mbi fitimin**

Shpenzimet për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshëm për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshëm i cili ndryshon nga fitimi tregëtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin është 15%.

- **Kërkesat për tu arkëtuar**

Kërkesat për tu arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për tu arkëtuar në para regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për tu arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme.

- **Pasivet financiare**

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për tu shlyer në para, në përgjithësi, mbahen me kosto e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme.



Treguesit kryesor të ecurisë së aktivitetit

AKTIVET

I - Aktivet Afat shkurtra

1- Aktivet Monetare

Gjendja e aktiveve material është e përbërë nga gjendja e llogarive bankare dhe gjendja e arkës ,të cilat janë të konfirmuar me Statement Bankare dhe ditarët e arkave.

Aktivitet monetare në fillim të perjudhës ishin 8,416,701 lekë dhe në fund të perjudhës janë ulur në vlerën 171,140 lekë, përkatësisht nga llogaritë Bankë (168,259 lekë) dhe Arkë 2,881 lekë

Mjete monetare në Bankë dhe Arkë me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020

	31 /12/2021	31 /12/2020
Para ne Arke	2881	100389
Para ne banka	168259	8316313
Totali	171140	8416701

2- Investime

Shoqëria nuk ka kryer investime gjatë viti ,prandaj nuk ka vlera në këtë zë .

3- Të drejta të arkëtueshme

3.1 - Nga aktiviteti i shfrytëzimit (klientë)

Ky zë është i përbërë :

	Viti 2021	Viti 2020
"Prodhim Mobilje" sha	4,052,778	4,281,640
Sha "NPV"	20,871,789	19,887,218
"Aeroporti Nënë Tereza" sha	519,567,257	519,567,257
"Prodhim Kablo" Shkodër	181,990,903	181,990,903
" Ndërmarrja Kripa" Vlorë	7,744,294	7,744,294
"Albturist TO" sha	26,040	
"Elber" shpk	7,900,000	7,900,000
Provizione Klient	-529,773,526	-529,773,526
TOTALI	212,379,535	211,597,787



Kërkesa të arkëtueshme në çelje më 01.01.2021 na paraqitet me vlerën **211,597,787** lekë . Vlera e klientëve , tek Shoqëria "Prodhim kablllo" Shkodër është **181,990,903** lekë .(Kjo vlerë është e përbërë prej 145,078,936 lekë, i përket Shoqërisë "Prodhim Kablllo" Shkodër. Deri në vitin 1998, vit në të cilin kjo shoqëri është transformuar në sha, Uzina e Telave ka qenë në bashkëpronësi me Korporatën Albbakër Tiranë dhe si e tillë, megjithëse kanë pasur llogari të veçanta , llogaritë e Uzinës së Telave Shkodër janë kontrolluar dhe përdorur nga Drejtoria e Përgjithëshme Albbakër Tiranë. Vlera 3,536,800 lekë përbëhet nga:Tren Xhabia përfaqëson detyrimin e lënë si debitor sipas raportit të auditit të MFE Nr. 8992, dt. 14.12.2007, si dhe shuma për Elvis Pjalmin në raporin e auditit Nr 2995/4 dt. 1.09.2009. Firma Nika është debitore për shkak të mos arkëtimit të shumës , së shitur më shumë se kontrata e nënshkruar . Ka pasur komunikime të herë pas hershme , por nuk është zgjidhur .Detyrimi për ish drejtorin Dritan Kraja është detyrim sipas akt- kontrollit të Drejtorisë së Auditit të brendshëm të MFE Nr2301/6 dt29.07.2011). Klientët e shoqërisë "Prodhim Mobijle" sha paraqiten në vlerën **4,052,778** lekë , e pandryshuar mbetet vlera e kërkesave ndaj klientëve të shoqërisë Aeroporti Nënë Tereza **519,567,257** lekë , "Ndërmarrja Kripa" Vlorë **7,744,294** lekë dhe "Elber" shpk **7,900,000** lekë . Shoqëria Sha "NPV" e ka vlerën e kësaj kërkesë **20,871,789** lekë. "Albturist TO" sha ka kërkesë ndaj klientëve vlerën 26,040 lekë. Më 31.12.2021 vlera e kërkesave për arkëtim janë në vlerën **212,379,535** lekë

Këto kërkesa të arkëtueshme nga shoqëritë e përthithura, ku një pjesë e konsiderueshme e tyre janë të mbartura nga periudhat e kaluara, të cilat kanë mundësi të pakta për arkëtim, disa prej të cilave kanë vlera të pa detajuara , pasaktësi në emërtime dhe në 84% të tyre nuk ka adresa të sakta .

Nga ana jonë , janë dërguar shkresa, për ndjekjen e këtyre klientëve, por nuk kemi gjetur adresa të tyre, çka vërtetohet nga letrat e konfirmimeve të dërguara dhe të kthyera pa përgjigje. Zëri Klient tek shoqëria Aeroporti "Nënë Tereza" janë krijuar mbi 10 vjet, gjithashtu edhe "Ndërmarrja Kripa" Vlorë këtë zë e ka të krijuar për mbi 10 vjet .

Në këtë zë janë përfshirë dhe klientë të cilët janë provizionuar në vlerën **(529,773,526)** lekë, të cilat janë të mbartura nga shoqëritë e përthithura dhe me konkretish: nga Shoqëria Aeroporti "Nënë Terza" në vlerën 518,546.405 , çka do të thotë që këta klientë janë pa shpresë arkëtimi. Për këtë shoqëri, këta klientë janë provizionuar sipas shkresës me Nr.Prot.3877/1 datë 25.05.2015, kurse në Shoqërinë Sha "NPV" në vitin 2012 janë zhvlerësuar 9 (nëntë) klientë dhe kanë kaluar në humbje në vlerën (11,227,121) lekë.

3.2 - Kërkesa të tjera nga njësitë ekonomike Brenda grupit ku ka interesa pjesmarrje

Ky zë paraqitet në pasqyrat financiare në vlerën **566,867** lekë më konkretisht:

	Viti 2021	Viti 2020
"Sha "NPV"	566,867	566,867
TOTALI	566,867	566,867

Sipas raportit me përthithje "Kërkesa të tjera nga njësitë ekonomike" në fund të vitit 2019 paraqitet në vlerën 566,867 dhe i përket shoqërisë NPV sha . Kjo vlerë paraqet kërkesën për arkëtim ndaj MFE.



3.3 - Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese (diferenca inventari)

	Viti 2021	Viti 2020
"Prodhim Kablo" Shkodër	89,474,219	89,474,219
TOTALI	89,474,219	89,474,219

Në pasqyrat financiare të shoqërisë "Prodhim Mobilje" sha, vlera 89,474,219 lekë është diferencë në AAM të marra nga Konkensionari Albcable. Kjo vlerë i përket shoqërisë së përthithur me urdhrin Nr. 116 datë 05.12.2019 të Asamblesë së Përgjithëshme (Shoqëria "Prodhim Kablo" Shkodër është marrë në dorëzim nga komisionet e ngritura nga të dy ministritë me shkresën Nr. 15061 prot. datë 17.12.2018, ajo e MZHETTS me shkresën Nr 2007/4 datë 25.05.20017, Nr .8929/3 datë 24.05.2017 dhe MIE me shkresën Nr. 4136 datë 28.12.2017. Komisioni i marrjes në dorëzim është kryer në perjudhën Qershor- Tetor 2018, sipas parashikimeve në Urdhrat e OSHA)

3.4 - Të tjera të arkëtueshme

	Viti 2021	Viti 2020
"Prodhim Mobilje" sha	2,645,67	2,645,670
"Aeroporti Nënë Tereza" sha	177,615,201	177,615,201
"Sha "NPV	81,308,912	83,944,811
"Prodhim Kablo" Shkodër	3,536,800	3,536,800
"Albturist TO" sha	1,183,681	1,183,681
"Ndërmarrja Kripa" Vlorë	293,831,551	293,831,551
"Aeroporti Nënë Tereza" sha	1,325,663	2,135,172
TOTALI	561,447,398	564,892,886

Tatim Fitimi	Viti 2021	Viti 2020
"Aeroporti Nënë Tereza" sha	99,881,132	99,881,132
Sha "NPV"	1,254,581	1,254,581
"Ndërmarrja Kripa" Vlorë	4,829,887	4,829,887
"Elber" shpk	11,709,482	11,709,482
TOTALI	117,675,082	117,675,082

TVSH	Viti 2021	Viti 2020
"Elber" shpk	14,955,097	14,955,097
"Aeroporti Nënë Tereza" sha	204,994,830	204,994,830
TOTALI	219,949,927	219,949,927



Kërkesa të tjera ndaj punonjësve paraqitet në vlerën 513,182 lekë .

	Viti 2021	Viti 2020
"Prodhim Mobilje" sha	513,182	672,282
TOTALI	513,182	672,282

	Viti 2020	Viti 2021
Fatmir Cibaku	329,773	329,773
Mustafa Dakoli	650	650
Sonila Tahiri	650	650
Denis Demiri	29	29
Pavlina Konini	148,788	
Laureta Jani	96,280	96,280
Evisa Hasani	85,800	85,800
Nevila Sadiku	10,312	
Shuma	672,282	513,182

Të tjera kërkesa tatime-taksa

	Viti 2021	Viti 2020
"Prodhim Mobilje" sha	1,019,833	1,019,833
"Prodhim Kablo" Shkodër	453,325	453,325
"Elber" shpk		
TOTALI	1,473,158	1,473,158

Zëri "Kërkesa të tjera të arkëtueshme" në total 901,058,827 lekë të cilat janë ulur që nga fillimi të cilat kanë qenë 904,663,335 lekë. Në këtë zë janë të përfshira kërkesa për debitorë e kreditorë të ndryshëm të mbartura nga shoqëritë e përthithura në vlerën 561,447,398 lekë ,kërkesa ndaj punonjësve në vlerë 513,182 lekë(të dhëna parapagime), Tatim Fitimi i mbipaguar në vlerën 117,675,082 lekë, kërkersë për TVSH për tu marrë në vlerën 219,949,927 lekë, mbipagime taksa etj. për organet tatimore në vlerën 1,473,158 lekë .

4 – Inventarët

4.1 -Lëndë e parë dhe materiale te konsumueshme

	Viti 2021	Viti 2020
Prodhim Mobilje" sha	282,651	355,524
NPV	1,198,348	1,198,348
"Prodhim Kablo" Shkodër	13,016,528	13,016,528
TOTALI	14,497,527	14,570,400



Gjendja Inventarë paraqet vlerën e materialeve gjendje në magazinë në vlerën 14,497,527 lekë. Prej nga 14,299,692 lekë janë konsum materiale nga magazina, 11,000 lekë janë inventar i imët, për të cilat janë përdorur politikat e vlerësimit të inventarit me çmimin e blerjes

Në zërin inventar kemi edhe produkte të gatshme druri(orendi zyre etj.) në vlerën 186,835 lekë të cilat janë në përdorim nga shoqëria. Për vlerën 13,016,528 lekë që (i përket shoqërisë së përthithur "Prodhim Kablo" Shkodër nuk disponojmë inventarë të dorëzuar nga drejtuesit e shoqërisë)

4.6- AAGJM të mbajtura për shitje

Shoqëria ka mbajtur në inventar për shitje edhe makineri dhe pajisje (pajisje për pjesë turbine HEC, rregullator presioni e firmës "Gastel" në vlerën 8,396,650 lekë e ardhur nga shoqëria e përthithur TEC Tiranë). Janë bërë përpjekje për ta shitur apo transferuar tek shoqëri të tjera shtetërore të këtij profili , por kjo pajisje është e teknologjisë së vjetër e cila aktualisht nuk po gjen përdorim . Kemi kërkuar nga aksionari që të kryehet ekspertim me teknikienë të fushës për rivlerësimin dhe sugjerimin për të vepruar në vijim.

Totali i Aktiveve Afatshkurtra për 1,226,544,765 lekë

II - Aktivët Afatgjata

8 - Aktive materiale

8.1- Aktivët Afatgjata

Përbëhen nga zëri "Toka dhe Ndërtesa" në pronësi të shoqërisë, në vlerën 3,365,857,372 lekë

TOKA

	Viti 2021	Viti 2020
"Prodhim Mobilje" sha	1,633,767,789	1,633,767,789
Sha "NPV"	9,612,375	9,612,375
"Aeroporti Nënë Tereza" sha	1,712,580	1,712,580
"Prodhim Kablo" Shkodër	1,112,858,500	1,112,858,500
" Ndërmarrja Kripa" Vlorë	81,487,000	81,487,000
"Albturist TO" sha	53,936,000	53,936,000
"Elber" shpk	0	0
TOTALI	2,893,374,244	2,893,374,244

NDËRTESA

	Viti 2021	Viti 2020
"Prodhim Mobilje" sha	65,428,587	68,872,198
Sha "NPV"	114,616,931	115,116,931
"Prodhim Kablo" Shkodër	287,281,466	302,401,545
" Ndërmarrja Kripa" Vlorë	2,675,707	2,816,534
"Albturist TO" sha	2,339,608	2,462,746
"Elber" shpk		
TOTALI	472,483,127	491,669,954



8.2- MAKINERI DHE PAJISJE

Zëri *Impiante dhe Makineri* përfaqësojnë vlerën e mbetur të këtyre pajisjeve dhe makinerive. (makineritë dhe pajisje u përkasin shoqërive të përhithura të cilat janë në gjendje të amortizuar dhe nuk janë në gjendje pune, për të cilat nuk është llogaritur amortizimi. Pjesa më e madhe janë jashtë përdorimit të specifikuara për; a- jashtë përdorimi, b- skrap dhe c- asgjesim)

	Viti 2021	Viti 2020
Sha "NPV"	5,343,4874	5,343,484
"Prodhim Kabllo" Shkodër	63,791,528	63,791,528
" Ndërmarrja Kripa" Vlorë	276,344	276,344
"Prodhim Mobilje" sha	0	
TOTALI	69,411,356	69,411,356

8.3 - Aktive të tjera afatgjata

	Viti 2021	Viti 2020
"Prodhim Mobilje" sha	157,885	200,822
"Aeroporti Nënë Tereza" sha	164,525	209,017
Sha "NPV"	1,774,539	2,228,082
TOTALI	2,096,949	2,637,920

Të tjera instalime dhe pajisje paraqiten në vlerën 2,096,949 lekë janë vlera e mbetur e orendive të zyrave dhe pajisje informatike ; pasi u është zbritur amortizimi sipas Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit me normën 25%.

10.1- Koncensione, patenta, licensa, makra tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme

Zëri Koncensione paraqitet në vlerën **22,852,396,600** lekë.

Kjo vlerë përbëhet nga toka, ndërtesa ,makineri e pajisje , mjete transporti. Për këto Aktive nuk kemi inventar fizik pasi janë dhënë me konçension.

	Viti 20201	Viti 2020
"Aeroporti Nënë Tereza" sha	6,069,251,032	6,069,251,033
"Ndërmarrja Kripa Vlorë"	16,783,145,569	16,783,145,569
TOTALI	22,852,396,601	22,852,396,601

Totali i Aktiveve Afatgjata për 26,289,762,280 lekë



AKTIVET TOTALE 27,516,307,045 lekë

Shënime në lidhje me Asetet e paçertifikuara

- Shoqëria ka asete pa Çertifikatë për këto shoqëri :
- Ish "Ndërmarrja Kripa" Vlorë nuk është paisur me çertifikatë pronësie, për të cilën është aplikuar disa herë dhe nuk kemi marrë përgjigje. Për këtë ka ndërhyre edhe Ministria pranë Kadastres Vlorë , por nuk është zgjidhur problemi.
- Ish "Albturist TO" sha Tiranë i ka asetet të gjitha me kartelë pasurie , por nuk janë të pajisura me Çertifikatë Pronësie.Do të aplikohet për tu pajisur me Çertifikatë Pronësie
- "Prodhim Mobilje" sha të gjitha asetet i ka të pajisura me Certifikatë Pronësie , pervec Pasurisë 5/5 Zona kadastrale 8240 me sipërfaqe 2766.92 që është rrugë dhe është aplikuar për tu pajisur , por nga përgjigja e Kadastres na është thënë që nuk certifikohen rrugët e lira.Nga certifikatat e aseteve qe disponon shoqëria mungojne 2 certifikata për pasuritë:
 1. 354/1, Zona kadastrale 3292,
 - 2 . 354/6 Zona kadastrale 3292Në lidhje me keto 2 pasuri shpjegojme se më datë 22.09.2020 në llogarinë e bankës BKT të shoqërisë , janë kryer dy derdhje financiare me vlerë respektivisht : a- vlera 4,267,740 leke , b – vlera 264,100 lekë sipas kontratave a- Nr. Rep 3593 dhe Nr Kol 1944: b-Nr.Rep 3591 dhe Kol 1943. Të dyja këto kontrata kanë objekt shitjen e një toke Truall të lidhura me datë 08.09.2020. Për këtë problematikë i është dërguar shkresë me Nr. prot 144, datë 24.05.2021 urgjente Minisres së Ekonomisë dhe Financës si dhe për dijeni Këshillit Mbikqyrës, ku është kërkuar dhe një audit me shkresë Nr. Prot 145 datë 24.05.2021. Për këtë problem është bërë një Kërkesë Padi pranë Gjykatës Tiranë me objekt " Kthimin në gjendjen e mëparëshme të Pronës" me Nr. Prot 220 datë 12.07.2021
- Ish NPV SHA Durrës ka asete të pa certifikuara nga ISH n.Goma Durrës , Zona Kadastrale 8515, sipërfaqe trualli 885 m2 , nga e cila 500 m2 rrugë e cila nuk çertifikohet sipas ZVRPP. Gjithashtu të pa çertifikuara 1208 m2 që i përket Ish NPV 2,.Trual me sipërfaqe 1905 m2 të Ish NPV 2, NPV 3 . Ish NSHPN Dega Sarandë, Zona Kadastrale 8641 ka të paçertifikuar ndërtesë me sipërfaqe 313 m2

II - DETYRIMET DHE KAPITALI

12 - DETYRIMET AFATSHKURTRA

12.1 - Titujt e huamarjes Huamarrjet

	Viti 2021	Viti 2020
"Elber" shpk	174,413,534	174,413,534
TOTALI	174,413,534	174,413,534

Shoqëria "Elber" shpk (e përthithur) ka marrë një hua nga një Bankë Gjermane .Nuk e disponojmë këtë kontratën . Vlera e kësaj Huaje është **174,413,534** lekë . Për këtë hua nuk kemi informacion të detajuar.



Kjo hua nuk është kërkuar nga Kredituesit që nga viti 2013. Nuk e dimë a duhen llogaritur kamatat dhe interest .

12.3- Aktëtime në avancë për porosi

Zëri "Arkëtime në avancë" përfaqëson parapagimet nga subjektet , sipas kushteve të kontratave 1 dhe 10 vjeçare. Kjo llogari përbëhet nga:

	Viti 2021	Viti 2020
"Prodhim Mobilje" sha	798,515	805,158
Sha "NPV"	135,765	156,770
TOTALI	934,280	961,928

Shoqëria iu detyrohet qiramarrësve për arkëtime në avancë të garancisë së kontratës dhe parapagime në vlerën **934,280 lekë**.

12.4- Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

Për pjesën e detyrimeve , zëri "Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit" (furnitorë), përfaqëson detyrimin e shoqërisë ndaj furnitorëve në vlerën **16,897,961 lekë** (furnitorë të vjetër dhe të rinj të pa likjuar deri më 31.12.2021). Për shumicën e këtyre furnitorëve vlen të thuhet se nuk kemi adresa të sakta dhe mungesë dokumentacioni. Detyrimet e shoqërisë deri më 31.12.2021

	Viti 2021	Viti 2020
"Prodhim Mobilje" sha	6,463	6,470
Sha "NPV"	1,572,070	1,572,070
Prodhim Kablo" Shkodër	4,012,161	4,012,161
" Ndërmarrja Kripa" Vlorë	8,304,418	8,304,418
"AeroportiNënë Tereza" sha	3,002,848	3,002,848
TOTALI	16,897,961	16,897,967

12.5- Dëftesa të pagueshme

	Viti 2021	Viti 2020
Sha "NPV"	88,039,333	88,039,333
TOTALI	88,039,333	88,039,333

Këto janë detyrime kundrejt MFE,(të Agjensia Detare Taulantia) , me urdhër të Ministrit ka kaluar tek shoqëria Sha NPV të gjitha detyrimet kreditore dhe debitore, ku edhe ish shoqëria Sha "NPV" është përthithur nga shoqëria "Prodhim Mobilje" sha



12.7- Të pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesmarrëse

Të pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit paraqiten në vlerën **83,994,146 lekë** janë detyrimet që shoqëria ka ndaj Aksionarit për 30% e të ardhurave nga qiradhënia. Ky detyrim është i përbërë nga:

	Viti 2021	Viti 2020
"Prodhim Mobilje" sha	24,181,252	19,113,320
Sha "NPV"	49,461,743	49,461,743
"Aeroporti Nënë Tereza" sha	10,351,151	10,351,151
TOTALI	83,994,146	78,926,214

12.8- Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore

Të pagueshme ndaj punonjësve dhe kontribute për sigurimet shoqërore paraqiten në vlerën **19,643,051 lekë** (ku përfshihen kryesisht sigurimet për ish punonjësit e shoqërive të përthithura, shpërblime për Këshillat Mbikqërës të shoqërive të përthithura). Ky detyrim ka ardhur duke u ulur në krahasim me çeljen e periudhës.

Detyrime për paga ndaj punonjësve dhe Këshillave Mbikqyrës:

	Viti 2021	Viti 2020
"Prodhim Mobilje" sha	857,623	417,386
"Aeroporti Nënë Tereza"	1,864,303	1,864,303
"Prodhim Kablo" Shkodër	2,584,724	2,584,724
"Ndërmarrja Kripa" Vlorë	5,246,410	5,246,410
"Prodhim Mobilje" sha	150,159	2,932,255
TOTALI	10,667,219	13,009,078

Të pagueshme për kontribute për sigurimet shoqërore:

	Viti 2021	Viti 2020
"Prodhim Mobilje" sha	418,268	199,167
"Aeroporti Nënë Tereza" sha	1,678,679	1,678,679
"Ndërmarrja Kripa" Vlorë	7,019,284	7,019,284
"Albturist TO" sha	25,947	25,947
"Prodhim Kablo" Shkodër		99,603
Sha "NPV"		51,564
TOTALI	8,975,832	9,074,244



12.9 - Të pagueshme për detyrime tatimore

Të pagueshme ndaj organeve tatimore , Tap, tatim në burim në vlerën **90,507,392 lekë**

	Viti 2021	Viti 2020
Prodhim Mobilje" sha	108,669	74,219
Sha "NPV" + Kripa" Vlorë	90,389,233	90,452,299
"Elber" shpk	1,300	
"Albturist TO" sha	8,190	
TOTALI	90,507,392	90,526,518

12.10 - Të tjera të pagueshme

	Viti 2021	Viti 2020
"Prodhim Mobilje" sha	13,951,652	13,951,652
"Aeroporti Nënë Tereza" sha	5,695,442	5,695,442
"Prodhim Kabllo" Shkodër	11,072,499	11,072,499
" Ndërmarrja Kripa" Vlorë	3,057,594	3,057,594
TOTALI	33,777,187	33,777,187

Vlera prej 13,951,652 lekë përbëhet nga(**710, 429** lekë e krijuar në vitet 2000-2013, deri tani nuk ka pasur kërkesa për shlyerjen e këtij detyrimi. Kreditori Juled Beqiraj me vlerë **4,531,840** lekë ardhur si rezultat i shitjes së një Aktivi Afatgjatë Material në vitin 2020, për të cilën shoqëria ka marrë masa nëpërmjet shkresës Nr. Prot 220 datë 12.07.2021 , me objekt " **Kthimin në gjendjen e mëparëshme të Pronës**". **312,733** lekë Fonde për likuidimin e sigurimeve Shoqërore dhe shëndetsore të Kombinatit të Tekstileve të pambukta dhe Uzinës Mekanike. Vlera prej 8,396,650 lekë i përket (Aktiv afatgjat i mbajtur për shitje). Shoqëria "Aeroporti Nënë Tereza" sha, vlerën prej **5,695,442** lekë (janë parapagime të marra) . **3,057,594** lekë janë detyrime për klientë të shoqërisë " Ndërmarrja Kripa" Vlorë.**11,072,499** lekë janë marrë nga ish shoqëria "Prodhim Kabllo" Shkodër (përkatësisht 10,000,000 detyrime ndaj Shoqërisë Shtypshkronja e letrave me vlerë, krijuar në vitin 2019 , si dhe 1,072,499 detyrime të tjera , për të cilën nuk kemi dokumentacion).

14 - Të ardhura të shtyra

	Viti 2021	Viti 2020
Sha "NPV	3,457,290	3,457,290
"Prodhim Kabllo" Shkodër	9,081,825	9,081,825
TOTALI	12,539,115	12,539,115

Për sha NPV vlera 3,457,290 lekë, janë si grande të ardhura nga Shoqëria Alpetrol ,(për shoqërinë ish Goma e bashkuar me NPV). 9,081,825 lekë janë të ardhura të perjudhave të ardhëshme, për të cilën nuk kemi dokumentacion kontabël dhe i përket ish "Prodhim Kabllo" Shkodër



15 – Provizione (afatshkurtra)

	Viti 2021	Viti 2020
“Albturist TO” sha	4,952,428	4,952,428
“Prodhim Kablo” Shkodër	614,010	614,010
TOTALI	5,566,438	5,566,438

Këto Provizionet afatshkurtra në vlerë **5,566,438** lekë i përkasin Shoqërive të përthithura “Prodhim Kablo” Shkodër në vlerën **614,010** lekë, e mbartur që nga viti 2017, si dhe “Albturist TO” sha në vlerën **4,952,428** lekë . Nuk kemi dokumentacion për të vërtetuar këto provizione.

TOTALI I DETYRIMEVE AFATSHKURTRA 516,312,438 lekë

16 - DETYRIMET AFATGJATA

16.2 - Detyrime ndaj institucioneve të kredisë

	Viti 2021	Viti 2020
“Aeroporti Nënë Tereza” sha	3,741,230,101	3,741,230,101
“Prodhim Kablo” Shkodër	30,907,114	30,907,114
TOTALI	3,772,137,215	3,772,137,215

Në këtë zë janë pasqyruar hua të afatgjata të marra nga Shoqëritë, më konkretisht:

Aeroporti NënëTereza ka një hua prej 3,741,230,101 lekë. Duhet theksuar se kjo kredi është marrë nga qeveria Shqiptare , Banka Shqiptare dhe shoqëria Aeroporti Nënë Tereza ndaj Bankës Gjermane Kfë. Me dhënien me koncesion të Aeroportit ,sipas kontratës me koncensionarin kjo hua do të shlyhej nga koncensionari deri në përfundim të kontratës. Shoqërisë bashkë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ka bërë përpjekje për të siguruar të dhëna nga institucionet qeveritare MFE, Banka e Shqipërisë ,të pagesave per këstet e kredisë nga koncensionari . Rivlerësimi I këtij detyrimi ,për ta kthyer në vlerë aktuale te mbetur conform kursit të valutës kërkon vendimmarrje nga Asambleja e Përgjithëshme , për shkak se ka kaluar kohë e gjatë pa u rivlersuar, përditësuar me pagesat e kryera nga koncensionari , efektet financiare e të cilës do të sillnin pasoja fiskale të papërbalueshme nga shoqëria.

Shoqëria “Prodhim Kablo”Shkodër ka të pasqyruar një huamarrje me vlerë 30,907,114 lekë , e cila rezulton që nga viti 1992. Për këtë hua nuk kemi analizë dhe asnjë dokumentacion pranë shoqërisë tone.



16.7 -Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesmarrëse

	Viti 2021	Viti 2020
"Prodhim Kablo" Shkodër	10,000,000	10,000,000
TOTALI	10,000,000	10,000,000

Shoqëria Prodhim Kablo Shkodër ,në vitin 2002 ka marrë nga Autoriteti Portual Durrës një fond me vlerë **10,000,000** lekë. Nuk kemi dokumentacion kontabël për ta vërtetuar

16.8 - Të tjera të pagueshme

Të tjera të pagueshme në vlerën **5,882,352** lekë përbëhet nga : (5,600,000 lekë të ardhura të shtyra nga Regjistri Detar Durrës sipas Vendimit të Asamblese Nr.96, Nr.22383 Prot/Dt. 14.12.2021, si dhe vlera 282,352 lekë të ardhura nga Herigen Gjoka për qiranë e pronës në Syrin e Kaltër).

18 - Të ardhura të shtyra afatgjata

	Viti 2021	Viti 2020
"Prodhim Kablo" Shkodër	1,000,000	25,931,825
TOTALI	1,000,000	25,931,825

I përket Shoqërisë Prodhim Kablo Shkodër në vlerë **1,000,000** lekë . Për këtë zë nuk kemi analizë dhe asnjë dokumentacion mbështetës.

19 – Provizione

19.2 – Provizione të tjera

	Viti 2021	Viti 2020
" Ndërmarrja Kripa" Vlorë	121,369,056	121,369,056
"Prodhim Kablo" Shkodër	150,272,292	150,272,292
TOTALI	271,593,776	271,593,776

Ky zë paraqitet në vlerën **271,593,776** lekëdhe u përket këtyre shoqërive . Për këtë zë nuk kemi analizë dhe asnjë dokumentacion kontabël mbështetës .

Totali i Detyrimeve Afatgjata 4,060,660,915 lekë

I **TOTALI I DETYRIMEVE 4,586,973,353 lekë**



II Kapitali dhe Rezervat

21 - KAPITALI

Kapitali i nënshkruar, pas bashkimit të Shoqërisë është në vlerën **22,474,440,565** lekë

	Viti 2021	Viti 2020
Kapitali I Nënshkruar	22,474,440,565	22,474,440,565
Primi I lidhur me kapitalin	102,743,993	102,743,993
Rezerva rivlerësimi	983,492,360	983,492,360
Rezerva ligjore	2,354,045	2,354,045
Rezerva të tjera	107,795,563	107,795,563
Fitim/Humbje e pashpërndarë	(702,340,609)	(673,299,236)
Fitim(Humbja) e Vitit	(39,332,224)	(29,041,373)
TOTALI	22,929,333,693	22,968,665,917

Gjendja *Kapitali i Nënshkruar* është në vlerën **22,474,440,565** lekë. Përfaqëson vlerën e kapitalit të nënshkruari cili me urdhërat Nr. 112-117, datë 05.12.2019 dhe raportit të bashkimit me përthithje (gjashtë shoqëri), datë 06.04.2020 të shoqërisë "Prodhim Mobilje" sha është rritur. *Primi i lidhur me kapitalin* është në vlerën **102,743,993** lekë. *Rezerva të Rivlerësimit* në vlerën **983,492,360** lekë si dhe *rezerva të tjera ligjore* në vlerë **2,534,045** lekë dhe *rezerva të tjera* në vlerën **107,795,563** lekë (të cilat janë të pandryshuara nga perjudha paraardhëse).

Humbja e mbartur e shoqërisë nga perjudha të kaluara është -702,340,609 lekë. Zëri Fitim/Humbja e perjudhës financiare është humbja e shoqërisë e krijuar gjatë vitit 2021 në vlerën - 39,332,224 lekë.

DETYRIMET DHE KAPITALI TOTAL (I+II) 27,516,307,045 lekë

Performanca

(Të Ardhura dhe Shpenzime)

Paraqitja e Pasqyrës së të Ardhurave dhe SHpenzimeve është bërë duke i klasifikuar sipas natyrës

TE ARDHURAT	Viti 2021	Viti 2020
Nga aktiviteti i shfrytëzimit	11,780,638	12,347,205
Të ardhura të tjera shfrytësimi	100,975	4,320,362
Të ardhura të tjera		47,697,030
Totali i të ardhurave	11,881,594	64,364,597

Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit – të ardhura nga qiraja 11,780,637 lekë për vitin 2021. Të ardhurat direkte janë me një ulje të lehtë pasi janë ndërprerë 2 kontrata me subjekte dhe persona fizik (Erlind Tresa në maj 2021 dhe Tisa shpk në janar 2021). Zëri të ardhura të tjera shfrytëzimi në vlerën



100,975 lekë konsiston në të ardhura nga rivlerësimi i të ardhurave në valutë (pagesat e kryera nga klientë të ndryshëm në valutë) . Totali të ardhurave 11,881,613 lekë.

<u>SHPENZIMET</u>	<u>Viti 2021</u>	<u>Viti 2020</u>
Shpenzime lëndë e parë material	- 406,517	- 1,052,129
Shpenzime për paga	- 20,818,107	- 29,610,645
Shpenzime për sig shoqërore,shëndetsore	- 3,234,093	- 4,076,839
Shpenzime konsumi dhe amortizim	- 19,727,797	- 20,261,177
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	- 5,065,519	- 16,863,431
Zhvlërësimi i aktiveve afatgjata materiale		- 22,128,007
Shpenzime financiare	- 1,961,803	586,257
Totali i Shpenzimeve	(51,213,836)	(93,405,971)

Në shpenzimet e shoqërisë veçojmë *Lëndë e parë dhe material të konsumueshme* , ku bëjnë pjesë shpenzime për energji elektrike(256,818 lekë), shpenzime për blerje material (196,501 lekë), shpenzime për shërbimin e fiskalizimit (14,555 lekë).

Në zërin shpenzime të personelit , janë shpenzimet e shoqërisë për pagat e shpërblimet e punonjësve, në total në vlerën 24,064,799 lekë (paga punonjësish në vlerë 19,810,227 dhe Këshilli mbikqyrës 1,007,880 lekë) dhe për sigurime shoqërore dhe shëndetsore(në vlerën 3,246,692 lekë)

Zëri Spenzime konsumi dhe Amortizimi përbëhet nga amortizimi llogaritur për vitin 2021, i ndërtesave, pajisjeve informatike dhe orendive të zyrave etj në vlerën 19,727,797 lekë

Shpenzime të tjera shfrytëzimi përbëhen nga shpenzime për shërbime, riparime, paga ndërmjetëse (honorare), tatime, taksa, komisione bankare dhe gjoba në vlerën 6,975,557 lekë

Zërin shpenzime financiare paraqitet në vlerën 1,961,803 lekë (si rezultat i ndryshimeve në këmbimin valuator)

Në total shpenzimet e vitit 2021 janë **51,213,836** lekë.

Fitimi apo Humbja nga veprimtaria kryesore është humbje prej - 39,332,224 lekë dhe përfaqëson diferencën e të ardhurave të aktivitetit me shpenzimet direkte të ushtrimit.

Për të gjithë veprimtarinë e kryer gjatë perjudhës shoqëria nuk ka realizuar detyrimin ndaj shtetit në formën e tatim fitimit (zero lekë).

Rezultati për vitin 2021 është humbje për - 39,332,224 lekë, shifër e cila është transferuar edhe në bilancin kontabël në zërin përkatës të rezultatit të ushtrimit

REZULTATI I VITIT USHTRIMOR (HUMBJE) - 39,332,224 lekë

Hartoi

Suela MEÇI



Administratori

